

LGBTI DHE POLITIKA

Letër Avokuese

Hyrje

LGBTI në politikë është një temë e nënvlerësuar në përgjithësi, e në veçanti në Kosovë. Temë e cila shumë pak haset në agjendat e politikanëve sidomos kur bëhet fjalë për rregullimin, promovimin dhe avokimin e të drejtave të qytetarëve pa diskriminim duke u bazuar në ligj. Megjithatë, debati i fundit mbi martesat e personave të seksit të njëjtë i ka shtyrë politikanët dhe zyrtarët publikë që në mënyrë të turpshme t'i targetojnë personat lezbike, gej, biseksual, transgjisor dhe interseks (LGBTI) për përfitime politike duke nxitur paragjykitime dhe urrejtje. Në këtë mënyrë, zyrtarët publikë – disa edhe në nivelet më të larta – po dështojnë në ushtrimin e detyrës së tyre/saj për promovimin e dinjitetit të barazisë dhe drejtave të njeriut për të gjithë.

Në dekadën e fundit në Kosovë është shënuar progres i veçant. Janë miratuar ligje për mbrojtjen e personave LGBTI nga diskriminimi; gjuha e urrejtjes dhe krimi i urrejtjes; janë nndërmarrë hapa premtues nga qeveria për të ofruar mbrojtje për marrëdhëniet e personave të seksit të njëjtë; dhe e drejta për njohjen ligjore të gjinisë është pohuar fuqishëm nga gjykatat dhe së shpejti do të trajtohet me dispozitat e duhura ligjore. Në përgjithësi, qëndrimet e publikut ndaj personave LGBTI janë përmirësuar dukshëm dhe është rritur dukshmëria e personave LGBTI.

Megjithatë, progresi i viteve të kaluara i shoqëruar me homo/transfobinë e vazhdueshme në shoqërinë tonë, tashmë kanë ofruar terren të përshtatshëm për shfrytëzim nga lëvizjet politike oportuniste kundër të drejtave të njeriut. Prandaj, ky trend i manipulimit politik i homo/transfobisë në Kosovë duhet të trajtohet pa vonesa të mëtejshme.

Injorimi i personave LGBTI per perfitime politike

Kur politikanët përfshihen në diskutime për të drejtat LGBTI, veçanërisht në mes të një fushate elektorale, zakonisht shoqërohet me siklet dhe shqetësim. Ekziston një frikë e dukshme se të folurit për të drejtën ose personat LGBTI do të çonte në perceptimin se janë “njëri prej tyre” apo kanë lidhje me ta, dhe përfundimisht do të humbiste mbështetjen elektorale. Në zgjedhjet e fundit lokale, kandidatët konkurrues u përmbajtën nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI gjatë fushatave zgjedhore. Megjithatë, nevojat e votuesve LGBTI u neglizhuan plotësisht nga partitë politike të shumicës dhe programet e tyre të fushatës. Programet e tyre ishin shumë të fokusuar në infrastrukturë dhe planifikim urban, dhe më pak të fokusuar në çështjet e mirëqenies sociale dhe/ose barazisë sociale dhe të drejtave të njeriut. Në përgjithësi, grupet vulnerabël dhe të marginalizuara, përfshirë personat LGBTI, nuk e morën vëmendjen dëshiruar. Tabela e mëposhtme ilustron përfshirjen e çështjeve LGBTI nga kandidatët që konkurrojnë për Komunën e Prishtinës. Tabela është një pasqyrë e përmbajtjes së programeve të tyre elektorale dhe fjalimit të tyre gjatë fushatave elektorale për zgjedhjet vendore 2021.

Indikatorët	Kandidatët				
	<u>Arben Vitia</u> <u>Lëvizja Vetëvendosje</u>	<u>Avni Çakmaku</u> <u>Fjala</u>	<u>Përparim Rama</u> <u>Lidhja Demokratike e Kosovës</u>	<u>Uran Ismajli</u> <u>Partia Demokratike e Kosovës</u>	<u>Daut Haradinaj</u> <u>Aleanca per Ardhmerine e Kosovës</u>
Përmendja e çështjeve ose personave LGBTI në adresimet/fjalimet publike	Asnjë deklaratë publike lidhur me çështjet LGBTI.	Disa raste të nxitjes së qëllimshme të gjuhës së urrejtjes kundër komunitetit LGBTI. ¹	Mbështetje e deklaruar publikisht ndaj çështjeve LGBTI. ²	Asnjë deklaratë publike lidhur me çështje LGBTI.	Asnjë deklaratë publike lidhur me çështje LGBTI.
Programet politike që përfshinë të drejtat dhe/ose adresonin çështje LGBTI	Mospërfshirje e çështjeve LGBTI në programin elektorale. ³	Mospërfshirje e çështjeve LGBTI në programin electoral.	Mbështetje për krijimin e një strehimoreje dhe mbështetje për personat LGBTI në përgjithësi.	Mospërfshirje e çështjeve LGBTI në programin elektorale. ⁴	Seksioni për LGBTI+, që tregon mbështetjen e qartë të LGBTI dhe respektimin e simboleve LGBTI, IDAHOT, etj. ⁵

Në krahasim me Prishtinën, jeta LGBTI në Kosovë është “shumë e fshehtë”. Prishtina tashmë ka një gej klub dhe çdo vit organizohen parada dhe marshime të krenarisë. OJQ-të lokale që punojnë me komunitetin LGBTI janë të vendosura në Prishtinë dhe personat LGBTI nga qytete të ndryshme bëjnë të pamundurën për të jetuar në Prishtinë. Prandaj, pritej që kandidatët që garojnë për kryetarë të komunave të Prishtinës, në zgjedhjet lokale të vitit 2021, të kenë parasysh të gjitha këto dhe të ofrojnë programe zgjedhore më gjithëpërfshirëse. Megjithatë, siç shihet nga tabela 1, vetëm 2 nga 3 kandidatët kanë pasur këto konsiderata.

Fatkeqësisht, në zgjedhjet parlamentare të Shkurtit 2021, çështjet LGBTI u neglizhuan edhe më shumë nga partitë politike. Prandaj, kjo për shkak të kësaj neglizhence, kryesisht nga frika e humbjes së popullaritetit në bazën e tyre, ka ofruar terren të përshtatshëm për shfrytëzim nga lëvizjet politike oportuniste dhe kundër të drejtave të njeriut. Prandaj, ky trend i neglizhencës politike ndaj çështjeve LGBTI në Kosovë duhet të trajtohet pa vonesa të mëtejshme dhe partitë politike duhet të ndërmarrin një reformë strukturore dhe të ofrojnë programe më gjithëpërfshirëse

1. Insajderi, Avni Çakmaku: Nëse femija im do t'i takonte komunitetit LGBTI – Do ta lëcisja, available at: <https://insajderi.com/avni-cakmaku-nese-femija-im-do-ti-takonte-komunitetit-lgbti-do-ta-ləcisja/>

2. Postim ne Facebook i aktivitetit te Fushates Elektorale 2021, Perparim Rama takon perfaqesuesit e CSGD, i qasshem ne: <https://www.facebook.com/perparimrama2021/posts/172773578333972>

3. Programi Elektoral i Arber Vitia, Zgjedhjet Lokale 2021, i qasshem ne: <https://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2018/12/Prog-AV144-2021-FINAL.pdf>

4. Programi elektoral i Uran Ismajli, Zgjedhjet Lokale 2021, i qasshem ne: https://media1-prd-eu1-onlinefiles.info/4f68c284/a0a080f4/018b6a49/411ae1bf/media/document/1430/ui-programi_30a02fec.pdf?fbclid=IwAR1fjgAX7_SIDYg397-zPU6cl4J5RWP7RNT2x5P5SI28tPmr9IV2wOU5U

5. Programi elektoral i Daut Haradinaj, Zgjedhjet Lokale 2021, i qasshem ne: <https://www.facebook.com/1558607637525692/posts/4250596558326773/?d=n>

Stigmatizimi i personave LGBTI per perfitime

Diskutimet për martesat e personave të seksit të njëjtë të mbajtura së fundmi në Kuvendin e Kosovës përfaqësojnë një rritje shqetësuese të intolerancës ndaj personave LGBTI në Kosovë. Është e evidente se disa politikanë po instrumentalizojnë paragjykimet ekzistuese shoqërore dhe po sulmojnë verbalisht personat LGBTI për të arritur objektivat politike për përfitimin e tyre. Dënimi i pakicave LGBTI është bërë një taktikë e aplikuar nga politikanët ultra-konservatorë, nacionalistë dhe “fetarë” që paraqiten si mbrojtës të të ashtuquajturave “vlera tradicionale” për të forcuar bazën dhe përfitimin e tyre. Përveç mobilizimit të disa kategorive të votuesve, shfrytëzimi i homo/transfobisë shoqërore është një mënyrë e përshtatshme për të larguar vëmendjen e publikut nga çështjet më urgjente sociale dhe pabarazitë në rritje dhe sulmet më të gjera që po ndodhin ndaj të drejtave të njeriut dhe demokracisë.

Dispozita që shkaktoi debat të madh në mesin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, neni 1138, paragrafi 2, i draft Kodit Civil, i cili thotë se *“Bashkësitë e regjistruara civile ndërmjet personave me sekse të njëjta janë të lejuara. Kushtet dhe procedura rregullohen me ligj të veçantë”*. Homofobia triumfoi në Kuvendin e Kosovës. Labinote Demi-Murtezi, përfaqësuese e partisë në pushtet, tha se *“ajo e sheh si të pritshme martesën e personave të seksit të kundërt. Çdo lidhje jashtë këtij kombinimi konsiderohet shturje dhe degjenerim moral”*, të tjerë pohuan se kjo dispozitë e vetme ligjore, nëse miratohej, do të shkatërronte familjet e tyre. Kishte nga ata që u paraqitën si mbrojtës të kulturës dhe të *“vlerave tradicionale”*.

Intoleranca dhe paragjykimi e errësuan kuptimin e qartë të çështjes. Së pari, dispozita e mësipërme e Drat Kodit Civil i referohet **bashkësive të regjistruara civile** dhe **jo martesës**. Gjithashtu, tregon se bashkësitë e regjistruara civile do të rregullohen më tej me ligj të veçantë. Së dyti, siç theksohet nga organizatat e shoqërisë civile në nivel vendor dhe ndërkombëtar, si dhe aktorë të tjerë, dispozita e propozuar nuk ofron një mekanizëm përmes të cilit çiftet e seksit të njëjtë mund të gëzojnë plotësisht të drejtën e tyre për jetën familjare dhe private. Për më tepër, dispozita e propozuar është konsideruar si ndërhyrje e paligjshme në të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe standardet e tjera ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë.

Është e qartë se deputetët e Kuvendit të Kosovës janë ndikuar nga deklaratat publike e bërë nga bashkësitë fetare në Kosovë duke u kërkuar ligjvënësve që të mos legalizojnë martesat e të seksit të njëjtë.⁶ Dezinformatat juridike, faktike dhe logjike që përmbajnë deklaratat e bashkësive fetare, kanë qenë të pranishme në diskursin e disa deputetëve të Kuvendit. Është e evidente se ata udhëhiqen nga opinioni i masës, e jo nga vlerat e pasuruara në Kushtetutën e Kosovës. Në një shoqëri moderne, të drejtat dhe liritë individuale janë të panegociueshme dhe ato mbrohen dhe promovohen nga grupet e interesit dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut, të respektuara nga shoqëria dhe të garantuara nga Kushtetuta dhe kuadri ligjor i atij shteti. Prandaj, ligjvënësit duhet të marrin anën e shoqërive moderne dhe pikërisht për këtë shtrirje shteti ynë ka renditur një numër të madh të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve të tij. E drejta për t'u martuar dhe për të krijuar familje është e drejtë e garantuar e çdo qytetari të Kosovës⁷ dhe ajo duhet t'u sigurohet të gjithë qytetarëve pa diskriminim.⁸

Kjo sepse Kosova është shtet laik, demokratik, liberal dhe fokusohet tek qytetari dhe jo tek grupi shoqëror, gjë që shkruhet shumë qartë në preambulën e saj: *“Të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit”*

⁶ Deklarate e Përbashkët e Komunitetit Fetar, 23 Shkurt 2022, i qasshem: <https://www.facebook.com/birk2015/posts/4886865344683463>.

⁷ Neni 37, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se...Kosoves-2.pdf>.

⁸ Neni 24, po aty

Debati nëse duhet të rregullohen apo jo martesat e seksit të njëjtë është një debat që vazhdon prej dekadash. Përplasjet zakonisht ndodhin midis konservatorëve dhe liberalëve, me idenë e konservatorëve që mbrojnë shoqërinë nga “shkatërrimi”, “zhdukja”, etj. Kjo frikë e paarsyeshme identifikohet lehtësisht si homofobi dhe që është e rrezikshme për zhvillimin e shoqërive në të cilat individit ndodhet në qendër sepse mund të çojë në konflikt, denigrim e deri në dhunë fizike. Gjithashtu vlen të theksohet se në të gjitha demokracitë ku është hapur ky debat, në fund ka rezultuar me rregullimin e kësaj martese brenda legjislacionit të atij shteti.

Ndikim i demshem tek personat LGBTI

Targetimi i personave LGBTI për përfitime politike është një strategji e kushtueshme e cila dëmton jetën dhe mirëqenien e të prekurve dhe minon kohezionin social në përgjithësi. Kur zyrtarët publikë dhe politikanët e zgjedhur përdorin retorikë intolerante, kjo u sinjalizon të tjerëve se edhe ata mund të përfshihen në veprime urretjeje pa u ndëshkuar. Diskutimi rreth martesave të seksit të njëjtë në Kuvendin e Kosovës shkaktoi ngacmim ndaj personave LGBTI dhe aktivistëve në rrjetet sociale. Kjo mund të kontribuojë në rritjen e akteve të përditshme të dhunës.

Retorika toksike që targeton personat LGBTI pengon gjithashtu aftësinë e tyre për të marrë pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, duke përfshirë jetën politike dhe publike, dhe poashtu pengon qasjen e plotë në arsim, kujdes shëndetësor dhe punësim. Kjo mund të bëjë që shumë persona LGBTI të shmangen nga komunitetet tyre ose të kërkojnë të largohen krejtësisht nga vendi. Kjo atmosferë armiqësore mund t'i detyrojë personat LGBTI të jenë të mbyllur, në një fyerje të qartë ndaj dinjitetit të tyre njerëzor dhe të drejtës për të jetuar në liri dhe siguri. Një klimë urretjeje e promovuar nga zyrtarët publikë mund të ketë gjithashtu një ndikim të madh në shëndetin mendor të personave LGBTI.

Kosova ka miratuar dhe avancuar kornizën ligjore për mbrojtjen e personave LGBTI nga gjuha e urretjes dhe diskriminimi. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut kishte deklaruar qartë se gjuha e urretjes kundër personave LGBTI nuk mbrohet nga liria e shprehjes dhe as nga liria e besimit. Në anën tjetër, deputetët e Kuvendit të Kosovës po shprehin me krenari qëndrime anti-LGBTI. Partitë e tyre politike dhe përfaqësuesit publik nuk janë distancuar prej tyre. Kjo është qartë një shenjë e çmontimit të të drejtave ekzistuese LGBTI ose politikave pozitive, për shembull mund të pengojë hapat pozitivë të ndërmarrë në lidhje me njohjen ligjore të gjinisë.

Përkrahja e të drejtave të njeriut të një grupi pakicë mund të mos jetë gjithmonë me bazën politike të dikujt. Por ne kemi nevojë për politikanë që nuk kanë frikë të udhëheqin me shembull.

Rekomandime - Drejt vullnetit politik për përfshirje

Ky trend i manipulimit politik të homo/transfobisë në Kosovë duhet të trajtohet pa vonesa të mëtejshme.

Rekomandimet e mëposhtme duhet të adresohen:

- Partitë politike dhe politikanët nuk duhet të injorojnë ekzistencën e komunitetit LGBTI dhe çështjet e tyre themelore. Ata duhet të adresojnë çështjet LGBTI përmes programeve të menduara mirë dhe të bazuara në nevoja.
- Në përputhje me Rekomandimin e Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për luftimin e gjuhës së urrejtjes, ne u bëjmë thirrje partive politike, Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës që të marrin masa për të siguruar që politikanët të përmbahen nga komentet nënçmuese për personat LGBTI.
- Partitë politike dhe parlamentet duhet të miratojnë kode etike që ndalojnë dhe ndëshkojnë gjuhën e urrejtjes homofobike dhe transfobike.
- Përfaqësuesit e publikut duhet të dënojnë në mënyrë sistematike fjalimin homofobik dhe transfobik. Nuk duhet të ketë mosndëshkim për rastet veçanërisht të rënda të nxitjes së urrejtjes dhe dhunës nga politikanët.
- Përveç frenimit nga përhapja e urrejtjes, liderët politikë duhet të ndërmarrin hapa pozitivë për të nxitur një kulturë të trajtimit të barabartë dhe barazisë. Siç theksohet në Rekomandimin e Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për masat për të luftuar diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, “zyrtarët publikë dhe përfaqësuesit e tjerë shtetërorë duhet të inkurajohen të promovojnë tolerancën dhe respektimin e të drejtave të njeriut të personave LGBTI”.

Kosova është në udhëkryq në mbrojtjen dhe përfshirjen e personave LGBTI. Duke u ngritur për personat LGBTI, ne mbrojmë dinjitetin e barabartë njerëzor të të gjithëve, mbrojmë mirëqenien e shoqërive tona dhe fuqinë e sistemit tonë të çmuar të të drejtave të njeriut. Targetimi, dënimi ose injorimi i një grupi mund të ndikojë negativisht tek të gjithë ne.

⁹ Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe intolerancës, 'Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme N°15 për luftimin e gjuhës së urrejtjes', 8 Dhjetor 2016, i qasshem në: <https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/recommendation-no-15>.

¹⁰ Keshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Rekomandimi CM/Rec(2010)51 Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi masat e luftimit të diskriminimit në baze të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, 31 Mars 2010, i qasshem në: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805cf40a.



Embassy of Sweden
Pristina

